

**DIREKTIVA NR. 113, MBI ZBATIMIN E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË  
BARABARTË MIDIS BURRIT DHE GRUAS, NË AKSESIN DHE  
PËR OFRIMIN E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE**

*(13 dhjetor 2004)*

Këshilli i Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetin Evropian dhe në veçanti Nenin 13 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh Opinionin e Parlamentit Evropian,

Duke pasur parasysh Opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian,

Duke pasur parasysh Opinionin e Komitetit të Rajoneve,

Ndërsa:

1. Në përputhje me Nenin 6 të Traktatit të Bashkimit Evropian, Bashkimi është krijuar mbi bazën e parimeve të lirisë, demokracisë, respektit për të drejtat e njeriut dhe të lirive themelore dhe shtetit ligjor, parime të cilat janë të përbashkëta për shtetet anëtare, dhe respektojnë të drejtat themelore siç garantohen nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe siç rezultojnë nga traditat kushtetuese të përbashkëta për shtetet anëtare si dhe parimet e përgjithshme të së Drejtës Komunitare.

2. E drejta për barazi para ligjit dhe mbrojtjes kundër diskriminimit për të gjithë personat, përbën një të drejtë universale të njohur nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racial dhe të Konventave të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në të cilat të gjitha shtetet anëtare janë nënshkruese.

3. Ndërsa ndalohet diskriminimi, është e rëndësishme që të respektohen të drejtat dhe liritë e tjera themelore, duke përfshirë mbrojtjen e jetës familjare dhe private, dhe veprimet e kryera në atë kontekst dhe liria e besimit.

4. Barazia midis burrit dhe gruas është një parim themelor i Bashkimit Evropian. Nenet 21 dhe 23 të Kartës të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, ndalojnë çdo

diskriminim bazuar mbi seksin dhe kërkon që barazia midis burrit dhe gruas të sigurohet në të gjitha fushat.

5. Neni 2 i Traktatit që krijon Komunitetin Evropian, përcakton se sigurimi i një barazie të tillë, është një nga detyrat themelore të Komunitetit. Në mënyrë të ngjashme, Neni 3(2) i Traktatit kërkon që Komuniteti të synojë eliminimin e pabarazive dhe të nxisë barazinë midis burrit dhe gruas në të gjitha iniciativat e tij.

6. Komisioni ka shpallur qëllimin e tij, për propozimin e një direktive mbi diskriminimin seksual jashtë tregut të punës, në komunikatën e tij mbi Axfendën e Politikës Sociale. Një propozim i tillë është në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit nr. 51 (2001), të datës njëzet dhjetor dymijë, duke krijuar një Program në lidhje me strategjinë kuadër të Komunitetit mbi barazinë gjinore (2001-2005), që mbulon të gjitha politikat e Komunitetit dhe synon nxitjen e barazisë midis burrit dhe gruas, nëpërmjet rregullimit të këtyre politikave dhe zbatimit të masave praktike, për përmirësimin e gjendjes së burrit dhe gruas në shoqëri.

7. Në takimin e tij, në datat shtatë dhe nëntë dhjetor dymijë, në Nisë, Këshilli Evropian i bëri thirrje Komisionit, që të forcojë të drejtat lidhur me barazinë duke miratuar një propozim për një direktivë mbi nxitjen e barazisë gjinore në fusha të tjera përveç punësimit dhe jetës profesionale.

8. Komuniteti ka miratuar një sërë instrumentesh ligjor për të ndaluar dhe luftuar diskriminimin gjinor në tregun e punës. Këto instrumente kanë treguar vlerën e legjislacionit në luftën kundër diskriminimit.

9. Diskriminimi bazuar në gjininë, përfshirë ngacmimin dhe ngacmimin seksual, ndodh gjithashtu në fusha të tjera përveç tregut të punës. Një diskriminim i tillë është njësoj i dëmshëm, dhe vepron si pengesë për integrimin e plotë dhe me sukses, të burrit dhe gruas, në jetën ekonomike dhe sociale.

10. Problemet janë veçanërisht të dukshme në fushën e aksesit në/dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve. Prandaj diskriminimi i bazuar tek seksi duhet ndaluar dhe eliminuar në këtë fushë. Ashtu siç në rastin e Direktivës së Këshillit nr. 43 (2000), të datës njëzet e nëntë qershor, për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht nga raca dhe origjina etnike, ky objektivi mund të arrihet më mirë me anë të legjislacionit Komunitar.

11. Një legjislacion i tillë duhet të ndalojë diskriminimin e bazuar në gjininë për aksesin në/dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve. Me “mallra” do të kuptohen ato që parashikohen nga dispozitat e Traktatit që krijon Komunitetin Evropian në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave. Me “shërbime” do të kuptohen ato që parashikohen nga neni 50 i këtij Traktati.

12. Për të ndaluar diskriminimin e bazuar në gjininë, kjo Direktivë duhet të zbatohet si për diskriminimin direkt ashtu dhe për diskriminimin indirekt. Diskriminimi

direkt ndodh vetëm kur, duke u bazuar në gjininë, një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër në një situatë të ngjashme. Në përputhje me rrethanat, për shembull, diferencat midis burrit dhe gruas në dispozitat për shërbimet shëndetësore, të cilat kanë si shkak ndryshimet fizike midis burrit dhe gruas, nuk kanë lidhje me kushtet e ngjashme dhe për këtë arsye ato nuk përbëjnë diskriminim.

13. Ndalimi i diskriminimit duhet të zbatohet ndaj personave që ofrojnë mallra dhe shërbimeve, të cilat përdoren për publikun dhe të cilat ofrohen jashtë fushës së jetës familjare dhe private, dhe veprimeve të ndërmarra në këtë kontekst. Kjo gjë, nuk duhet të zbatohet në kuptimin e medias apo reklamave dhe as për arsimin publik ose privat.

14. Të gjithë individët gëzojnë lirinë për të lidhur kontratë, duke përfshirë dhe lirinë për të zgjedhur një palë kontraktuese për një veprim. Një individ i cili ofron mallra dhe shërbime mund të ketë një sërë arsyesh subjektive për zgjedhjen e tij/saj, si palë kontraktuese. Për aq kohë sa zgjedhja e palës kontraktuese nuk është e bazuar mbi gjininë e atij personi, kjo Direktivë nuk duhet të cenojë lirinë e individëve për të zgjedhur një palë kontraktuese.

15. Ekzistojnë, tashmë, një sërë instrumentesh ligjor për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrit dhe gruas në çështjet e punësimit dhe profesionit. Prandaj, kjo Direktivë nuk duhet të zbatohet në këtë fushë. Një arsyetim i ngjashëm zbatohet në lidhje me çështjet e vetëpunësimit për aq sa ato mbulohe nga instrumentet ligjor ekzistues. Kjo Direktivë duhet të zbatohet vetëm për sigurimet dhe pensionet të cilat janë private, vullnetare dhe të ndara nga marrëdhëniet e punësimit.

16. Diferencat në trajtim mund të pranohen vetëm në qoftë se ato janë të justifikuara nga një qëllim i ligjshëm. Një qëllim i ligjshëm mund të jetë, për shembull, mbrojtja e viktimave të lidhura me dhunën seksuale (në raste të tilla si krijimi qendrave për një gjini të vetme), arsyet e jetës private apo moralit (në raste të tilla si të dispozitave për strehimin nga një person në një pjesë të shtëpisë së atij personi), nxitja e barazisë gjinore apo të interesave të burrit dhe gruas (për shembull struktura vullnetare vetëm me anëtarë të një gjinie), lirinë e organizimit në shoqëri (në rastet e anëtarësimit në klubet private me anëtarë vetëm të një gjinie), si dhe organizimi i aktiviteteve sportive (për shembull ngjarjet sportive me pjesëmarrës vetëm të një gjinie). Çdo kufizim duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm në përputhje me kriteret që rrjedhin nga praktika e Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Evropiane.

17. Parimi i trajtimit të barabartë midis burrit dhe gruas për të ofruar mallra dhe shërbime, nuk kërkon gjithmonë që lehtësirat duhet t'iu sigurohen në mënyrë të barabartë, burrit dhe gruas, për aq kohë sa ato nuk iu sigurohen në mënyrë më të favorshme, personave të së njëjtës gjini.

18. Përdorimi i faktorëve të sigurimeve lidhur me gjininë shtrihet gjerësisht në dispozitat e sigurimit dhe në fushat e tjera të lidhura me shërbimet financiare. Në mënyrë që të sigurohet trajtimi i barabartë midis burrit dhe gruas, përdorimi i gjinisë si një faktor sigurimesh nuk duhet të ketë si rezultat diferencime në përfitimet dhe shpërblimet

individuale. Për të shmangur një ndryshim të papritur të tregut, zbatimi i këtij rregulli duhet të zbatohet vetëm për kontratat e reja të lidhura, pas datës së transpozimit të kësaj Direktive.

19. Kategori të caktuara të rreziqeve mund të ndryshojnë ndërmjet gjinive. Në disa raste, gjinia është njëri por jo domosdoshmërisht faktori i vetëm përcaktues në vlerësimin e rreziqeve të hasura. Për kontratat që sigurojnë këto lloje rreziqesh, shtetet anëtare mund të vendosin lejimin e përjashtimeve nga rregulli i përfitimeve dhe shpërblimeve për të dyja gjinitë për aq kohë sa ata mund të sigurojnë që faktorët e sigurimeve dhe të dhënat statistikore mbi të cilat janë bazuar llogaritjet, janë të besueshme, rregullisht të përditësuara dhe në dispozicion të publikut. Përjashtimet lejohen vetëm kur legjislacioni kombëtar nuk ka zbatuar ende rregullin për të dyja gjinitë. Pesë vjet pas transpozimit të kësaj Direktive në legjislacionin kombëtar, shtetet anëtare duhet të rishikojnë justifikimin për këto përjashtime, duke marrë parasysh të dhënat më të fundit statistikore të sigurimeve si dhe një raport nga Komisioni, tre vjet pas datës së transpozimit të kësaj Direktive.

20. Trajtimi më pak i favorshëm i gruas për shkak të shtatzënisë apo amësisë duhet të konsiderohet si një formë e diskriminimit direkt të bazuar në gjini dhe për këtë arsye të ndalohet në shërbimet e sigurimeve dhe në shërbimet e tjera financiare. Shpenzimet e lidhura me rrezikun e shtatzënisë apo amësisë nuk duhet t'i atribuohen vetëm anëtarëve të një gjinie.

21. Personat të cilët kanë qenë subjekt i diskriminimit të bazuar mbi gjininë duhet të kenë mjete të përshtatshme për mbrojtjen ligjore. Për të siguruar një nivel mbrojtjeje ligjore më të madhe, shoqatat, organizatat dhe personat tjerë juridikë duhet të autorizohen gjithashtu për tu angazhuar në proceset, nëse vendoset prej shteteve anëtare, në emër apo në mbështetje të çdo viktime, pa cenuar rregullat kombëtare të procedurës, lidhur me përfaqësimin dhe mbrojtjen para gjykatës.

22. Duhet të miratohen rregulla mbi barrën e provës kur, në pamje të parë ka një çështje diskriminimi dhe për tu zbatuar efektivisht parimi i trajtimit të barabartë, barra e provës duhet të zhvendoset tek pala mbrojtëse kur është sjellë prova e një diskriminimi të tillë.

23. Zbatimi efektiv i parimit të trajtimit të barabartë kërkon një mbrojtje të përshtatshme gjyqësore kundër viktimizimit.

24. Më qëllim nxitjen e parimit të trajtimit të barabartë, shtetet anëtare, duhet të inkurajojnë dialogun me personat e interesuar, të cilët, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe praktikën, kanë një interes të ligjshëm, për të kontribuar në luftën kundër diskriminimit të bazuar mbi gjininë në fushën e aksesit në/dhe ofrimit të mallrave dhe shërbimeve.

25. Mbrojtja kundër diskriminimit të bazuar mbi gjininë, duhet të forcohet me anë të ekzistencës së një strukture apo strukturash në çdo shtet anëtar, me kompetencë,

analizimin e problemeve të përfshira, studimin e zgjidhjeve të mundshme dhe sigurimin e një ndihme konkrete për viktimat. Struktura apo strukturat mund të jenë të njëjta si ato që kanë përgjegjësi në nivel kombëtar, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut apo ruajtjen e të drejtave individuale, apo zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

26. Kjo Direktivë përcakton kërkesat minimale, duke ju dhënë kështu shteteve anëtare mundësinë e paraqitjes apo mbajtjes së dispozitave më të favorshme. Zbatimi i kësaj Direktive nuk duhet të shërbejë për të justifikuar ndonjë kthim mbrapa në lidhje me situatën, e cila mbizotëron tashmë në çdo shtet anëtar.

27. Shtetet anëtare duhet të parashikojnë sanksione efektive, proporcionale, dhe zhdëmtuese në rastet e shkeljes së detyrimeve sipas kësaj Direktive.

28. Duke qenë se objektivat e kësaj Direktive, kryesisht, për të siguruar një nivel të përbashkët mbrojtjeje të lartë, kundër diskriminimit në të gjitha shtetet anëtare, i cili nuk mund të arrihet në mënyrë të mjaftueshme nga shtetet anëtare dhe që si rrjedhim për arsye të shkallës dhe efekteve të veprimit mund të arrihen më mirë në nivel Komunitar, Komuniteti mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç parashikohet në Nenin 5 të Traktatit.

Në përputhje me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në atë nen, kjo Direktivë nuk mund të tejkalojë atë çfarë është e domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave.

29. Në përputhje me paragrafin 34, të marrëveshjes ndër institucionale mbi hartimin e ligjeve më të mira, shtetet anëtare inkurajohen që të hartojnë për veten e tyre dhe në interes të Komunitetit, raportet e tyre vetjake, të cilat, për aq sa është e mundur, do të ilustrojnë lidhjet reciproke midis Direktivës dhe transpozimit të masave dhe bërjen e tyre publike,

Ka miratuar këtë direktivë:

## **KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Direktive është vendosja e një kuadri për luftimin e diskriminimit të bazuar mbi gjininë, në aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve, me qëllimin e bërjes efektive të parimit të trajtimit të barabartë midis burrit dhe gruas në shtetet anëtare.

### **Neni 2 Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj Direktive, do të zbatohen, përkufizimet e mëposhtme:

a. diskriminim direkt: kur një person, mbi bazën e gjinisë, trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa është trajtuar, trajtohet apo mund të trajtohet një person tjetër, në një situatë të krahasueshme;

b. diskriminim indirekt: kur një dispozitë neutrale në dukje, kriteret apo praktika, mund të vendosin personat e një gjinie në një disavantazh të veçantë, në krahasim me persona të gjinisë tjetër, përveç kur dispozitat, kriteret apo praktika, është e justifikuar objektivisht nga një qëllim i ligjshëm dhe mjetet për arritjen e atij qëllimi janë të përshtatshme dhe të domosdoshme;

c. ngacmim: kur një sjellje e padëshiruar e lidhur me gjininë e një personi, ndodh me qëllimin apo efektin e dhunimit të dinjitetit të një personi dhe krijimin e një atmosfere frikësuese, armiqësore, degraduese, poshtëruese apo fyese;

d. ngacmim seksual: ku çdo formë e sjelljes ngacmuese, të padëshiruar, fizike, verbale, jo verbale apo psikike, të një natyre seksuale, ndodh me qëllimin apo efektin e dhunimit të dinjitetit të një personi dhe krijimin e një atmosfere frikësuese, armiqësore, degraduese, poshtëruese apo fyese;

### **Neni 3 Fusha e zbatimit**

1. Brenda kufizimeve të kompetencave të akorduara Komunitetit, kjo Direktivë do të zbatohet për të gjithë personat, të cilët sigurojnë mallra dhe shërbime, të cilat janë të disponueshme për publikun pavarësisht personit të interesuar, lidhur me sektorët publikë apo privat, duke përfshirë strukturat publike, dhe të cilat ofrohen jashtë fushave të jetës private dhe familjare, dhe të veprimeve të ndërmarra në këtë kontekst.

2. Kjo Direktivë nuk cenon lirinë e individëve për të zgjedhur një palë kontraktuese për aq sa një zgjedhje e individëve të palës kontraktuese nuk bazohet në gjininë e atij personi.

3. Kjo Direktivë nuk duhet të zbatohet në fushën e medias apo reklamave dhe as për arsimin.

4. Kjo Direktivë nuk do të zbatohet në çështjet e punësimit apo profesionit. Kjo Direktivë nuk do të zbatohet në çështjet e vetëpunësimit për aq sa këto çështje mbulohen nga akte të tjera të legjislacionit Komunitar.

### **Neni 4 Parimi i trajtimit të barabartë**

1. Për qëllimet e kësaj Direktive, parimi i trajtimit të barabartë midis burrit dhe gruas, do të thotë që:

a. nuk do të ketë diskriminim direkt të bazuar mbi gjininë, duke përfshirë dhe trajtimin më pak të favorshëm të gruas, për shkak të shtatzënisë apo amësisë;

b. nuk do të ketë diskriminim indirekt të bazuar mbi gjininë.

2. Kjo Direktivë nuk do të cenojë dispozitat më shumë favorizuese për mbrojtjen e gruas të lidhura me shtatzëninë dhe amësinë.

3. Ngacmim apo ngacmim seksual në kuptimin e kësaj Direktive do të cilësohet se është diskriminimi i bazuar mbi gjininë, dhe për këtë arsye do të ndalohej. Refuzimi i një personi për ose nënshtrimi ndaj, një sjellje të tillë mund të mos përdoret si një kriter bazë për një vendim që prek atë person.

4. Urdhrat për diskriminim direkt apo indirekt të bazuar mbi gjininë do të cilësohen si diskriminim sipas kuptimit të kësaj Direktive.

5. Kjo Direktivë nuk pengon diferencat në trajtim, në qoftë se dispozitat e mallrave dhe shërbimeve, ekskluzivisht apo kryesisht, për anëtarët e njëjës gjini, justifikohen me një qëllim të ligjshëm dhe mjetet për arritjen e këtij qëllimi janë të përshtatshme dhe të domosdoshme.

## **Neni 5**

### **Faktorët e sigurimeve**

1. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha kontratat e reja të lidhura pas datës njëzet e një dhjetor dymijë e shtatë, si afati i fundit, ku përdorimi i gjinisë si një kriter në llogaritjen e shpërblimeve dhe përfitimeve, për qëllime sigurimi dhe shërbimesh të tjera financiare të lidhura me to, të mos rezultojnë me diferenca në shpërblimet dhe përfitimet individuale.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, shtetet anëtare mund të vendosin përpara datës njëzet e një dhjetor dymijë e shtatë, lejimin e diferencave proporcionale në shpërblimet dhe përfitimet e individëve, ku përdorimi i gjinisë është kriter përcaktues në llogaritjen e rrezikut të bazuar mbi të dhëna statistikore sigurimesh të sakta. Shtetet anëtare të interesuara do të informojnë Komisionin dhe do të sigurojnë që të dhënat e sakta, të lidhura me përdorimin e gjinisë si një faktor përcaktues sigurimesh, të hartohen, publikohen, dhe të përditësohen rregullisht. Këto shtete anëtare do të rishikojnë vendimin e tyre pesë vjet pas datës njëzet e një dhjetor dymijë e shtatë, duke marrë parasysh raportin e Komisionit të referuar në neni 16, dhe do t'i dërgojnë rezultatet e këtij rishikimi, Komisionit.

3. Për çdo rast, shpenzimet lidhur me shtatzëninë dhe amësinë nuk do të rezultojnë në diferencat në shpërblimet dhe përfitimet e individëve.

Shtetet anëtare mund të shtyjnë afatin e zbatimit të masave të domosdoshme për pajtueshmërinë me këtë paragraf deri në dy vjet pas datës njëzet e një dhjetor dymijë e shtatë, si afati më i fundit. Në atë rast shteti anëtar i interesuar do të informojë menjëherë Komisionin.

### **Neni 6 Veprime pozitive**

Me qëllim sigurimin e barazisë së plotë në praktikë të burrit dhe gruas, parimi i trajtimit të barabartë të burrit dhe gruas, nuk do të ndalojë asnjë shtet anëtar, për të mbajtur dhe miratuar masa specifike për ndalimin apo kompensimin e disavantazheve të lidhura me gjininë.

### **Neni 7 Kërkesat minimale**

1. Shtetet anëtare mund të paraqesin apo mbajnë dispozita, për mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë të burrit dhe gruas, të cilat janë më favorizuese sesa ato të përcaktuara nga kjo Direktivë.

2. Zbatimi i kësaj Direktive në asnjë rast nuk përbën bazë për reduktimin e nivelit të mbrojtjes kundër diskriminimit, tashmë të lejuara nga shtetet anëtare, në fushat që mbulohen nga kjo Direktivë.

## **KAPITULLI II ZGJIDHJET LIGJORE DHE ZBATIMI**

### **Neni 8 Mbrojtja e të drejtave**

1. Shtetet anëtare do të sigurojnë që procedurat gjyqësore dhe/ose administrative, duke përfshirë rastin kur ata e cilësojnë si procedurë të përshtatshme pajtimi, për zbatimin e detyrimeve sipas kësaj Direktive, të jenë në dispozicion për të gjithë personat, të cilët e konsiderojnë veten e tyre të prekur nga mos zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë ndaj tyre, edhe pasi ka përfunduar marrëdhënia në të cilën pretendohet të ketë ndodhur diskriminimi.

2. Shtetet anëtare do të paraqesin në sistemet e tyre ligjore kombëtare, masa të tilla, të cilat janë të domosdoshme, për sigurimin real dhe efektiv të kompensimit apo të dëmshpërblimit, sipas përcaktimit të shtetit anëtar, për humbjen apo dëmtimin e pësuar, nga një person i dëmtuar si rezultat i diskriminimit sipas kuptimit të kësaj Direktive, në një mënyrë e cila është e argumentuar dhe në proporcion me dëmin e pësuar. Vendosja e një kufizimi maksimal paraprak nuk kufizon një kompensim apo dëmshpërblim të tillë.

3. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që shoqatat, organizatat dhe personat e tjerë juridikë të cilat kanë, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni i tyre kombëtar, një interes të ligjshëm që të sigurohet zbatimi i dispozitave të kësaj direktive, mund të angazhohen, në interes apo në mbështetje të ankuesit, me aprovimin e tij apo të saj, në çdo procedurë gjyqësore dhe/apo administrative të parashikuar, për sigurimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga kjo Direktivë.

4. Paragrafët 1 dhe 3 do të zbatohen pa cenuar rregullat kombëtare mbi kufizimet kohore për marrjen e veprimeve të lidhura me parimin e trajtimit të barabartë.

### **Neni 9 Barra e provës**

1. Shtetet Anëtare do të marrin masa të tilla që janë të nevojshme, në përputhje me sistemet e tyre kombëtare gjyqësore, për të siguruar që, kur persona të cilët e konsiderojnë veten si të dëmtuar për shkak se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, dhe ku përpara një gjykate apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent, paraqiten faktet nga të cilat mund të prezumohet se ka pasur një diskriminim direkt ose indirekt, atëherë do të jetë i padituri, ai që do të provojë se nuk ka pasur asnjë shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

2. Paragrafi 1 nuk ndalon shtetet anëtare për paraqitjen e provave, të cilat janë më favorizuese për paditësin.

3. Paragrafi 1 nuk zbatohet në procedimet penale.

4. Paragrafi 1, 2 dhe 3 do të zbatohet gjithashtu dhe për çdo lloj procedimi të bërë në përputhje me nenin 8(3).

5. Shtetet anëtare nuk kanë nevojë që të zbatojnë paragrafin 1 për procedimet në të cilat, hetimi i fakteve të çështjes është detyrë e gjykatës apo e ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

### **Neni 10 Viktimizimi**

Shtetet anëtare do të paraqesin në sistemet e tyre ligjore kombëtare ato masa që janë të nevojshme për mbrojtjen e personave nga çdo trajtim i pafavorshëm apo me pasoja të pafavorshme si një reagim ndaj një ankese apo procedimi ligjor, që ka për qëllim zbatimin e detyrimeve në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë.

### **Neni 11 Dialogu me palët e interesuara**

Me synim nxitjen e parimit të trajtimit të barabartë, shtetet anëtare, do të inkurajojnë dialogun me palët e interesuara, të cilët kanë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe praktikën, një interes të ligjshëm për të kontribuar në luftën kundër diskriminimit mbi bazën e gjinisë në fushën e aksesit në/dhe ofrimit të mallrave dhe shërbimeve.

### **KAPITULLI III**

#### **STRUKTURA PËR NXITJEN E TRAJTIMIT TË BARABARTË**

##### **Neni 12**

1. Shtetet anëtare do të parashikojnë dhe do të bëjnë rregullimet e nevojshme për një strukturë apo struktura për nxitjen, analizimin, monitorimin dhe sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë personat pa asnjë lloj diskriminimi mbi bazë gjinie. Këto struktura mund të jenë pjesë e agjencive të ngarkuara në nivel kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut apo me ruajtjen e të drejtave individuale, apo për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

2. Shtetet anëtare do të sigurojnë që kompetencat e strukturave të referuara në paragrafin 1 të përfshijnë:

a. pa cenuar, të drejtat e viktimave dhe të shoqërive, organizatave apo personave të tjerë juridikë të referuar në nenin 8(3), duke siguruar ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminimin;

b. drejtimin e ekspertizave të pavarura në lidhje me diskriminimin;

c. publikimin e raporteve të pavarura dhe dhënien e rekomandimeve mbi çdo çështje të lidhur me një diskriminim të tillë.

### **KAPITULLI IV**

#### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

##### **Neni 13**

##### **Përputhshmëria**

Shtetet anëtare do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që parimi i trajtimit të barabartë të respektohet në lidhje me aksesin në/dhe për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve, brenda qëllimit të kësaj Direktive dhe në veçanti që :

a. të shfuqizohet çdo ligj, rregullore apo dispozitë administrative që është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë;

b. të deklarohet nulë dhe anulohet ose të ndryshohet çdo dispozitë kontraktuale, rregullat të brendshme të sipërmarrjeve, si dhe rregullat drejtuese të shoqërive fitimprurëse apo jo fitimprurëse të cilat janë apo mund të jenë kundër parimit të trajtimit të barabartë.

#### **Neni 14**

#### **Sanksione**

Shtetet anëtare do të hartojnë rregullat mbi sanksionet që do të zbatohen në rast shkeljesh të dispozitave kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj Direktive dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e tyre. Sanksionet, të cilat mund të përfshijnë pagesën për kompensimin e viktimës, duhet të jenë efektive, proporcionale dhe zhdëmtuese. Shtetet anëtare do të informojnë Komisionin për këto dispozita brenda datës njëzet e një dhjetor dymijë e shtatë si afati më i fundit, dhe do të informojë atë pa vonesë për çdo ndryshim pasues që ndikon në to.

#### **Neni 15**

#### **Shpërndarja e informacionit**

Shtetet anëtare do të sigurojnë që dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj Direktive, bashkë me dispozitat që lidhen me to e që janë tashmë në fuqi, të sillen në vëmendjen e personave të interesuar, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme, në të gjithë në territorin e tyre.

#### **Neni 16**

#### **Raportet**

1. Shtetet anëtare do t'i komunikojnë Komisionit të gjithë informacionin e mundshëm, në lidhje me zbatimin e kësaj Direktive, brenda datës njëzet e një dhjetor dymijë e nëntë, si dhe çdo pesë vjet pas kësaj date.

Komisioni do të hartojë një raport përmbledhës, i cili do të përfshijë një pasqyrë të praktikave aktuale të shteteve anëtare në lidhje me nenin 5, për sa i përket përdorimit të gjinisë si një faktor në llogaritjen e shpërblimeve dhe përfitimeve. Jo më vonë se data njëzet e një dhjetor dymijë e dhjetë, Komisioni do t'ia paraqesë këtë raport, Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Aty ku duhet, Komisioni do të shoqërojë raportin e tij me propozimet për ndryshimin e Direktivës.

2. Raporti i Komisionit do të marrë parasysh qëndrimet e grupeve të interesit.

#### **Neni 17**

#### **Transpozimi**

1. Shtetet anëtare do të miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative që janë të nevojshme për zbatimin e kësaj Direktive brenda datës njëzet e një dhjetor

dymijë e shtatë si afati më i fundit. Ato do t'i komunikojnë menjëherë Komisionit, tekstin e këtyre dispozitave.

Kur shtetet anëtare miratojnë këto masa, ato duhet të kenë një referencë me këtë Direktivë ose të jenë të shoqëruara nga një referencë e tillë, në rastin e publikimit zyrtar të tyre. Metodatat e publikimeve të referencave të tilla, do të vendosen nga shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare do t'i komunikojnë Komisionit, tekstin e dispozitave kryesore të ligjit kombëtar, që kanë miratuar, në fushën që mbulohet nga kjo Direktivë.

### **Neni 18**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi në ditën e publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

### **Neni 19**

#### **Adresimi**

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.